

RAPORT VJETOR I SHBSH-SË PËR VITIN 2008

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë gjatë vitit 2008 ka punuar për zbatimin e strategjisë së SHBSH-së. Janë realizuar një sërë veprimtarish si, takime me kryetarë të bashkive, takime midis përfaqësuesve të SHBSH-së dhe Qeverisë Qendrore, seminare tematike, këmbim përvoja brenda dhe jashtëvendit, vizita studimore si dhe botime të ndryshme.

Gjatë këtij viti janë zbatuar projektet në vazhdim e kanë filluar të tjerë që do t'i analizojmë me radhë. Menduam të rendisim disa probleme të ndjekura nga SHBSH gjatë vitit 2008.

I. Dhënia e mendimeve për projekt aktet normative

Një ndër drejtimet e veprimtarisë së SHBSH-së është studimi dhe vjelja e mendimeve për legjislacionin me ndikim në qeverisjen vendore që është zbatuar edhe gjatë këtij viti.

Do të përmendnim takimet e shumta mes ekspertëve të shoqatës dhe përfaqësuesve të Qeverisë e Parlamentit për projektligjin për “Planifikimin e Territorit”

Në fillim të muajit shkurt SHBSH ndërmorri një seri konsultimesh duke organizuar dy tryeza të rrumbullaketa me përfaqësues të bashkive dhe qeverisë për çështjen e projekt akteve nënligjore për Ligjin e Huamarrjes i cili u miratua në parlament në datë 2 shkurt. Tryeza nxorri konkluzione të rëndësishme për hartimin e akteve të nevojshme për zbatimin e ligjit të ri të huamarrjes.

II. Bashkëpunimi institucional

i. Midis SHBSH dhe bashkive

Bashkëpunimin midis SHBSH dhe bashkive ka qenë i dobishëm e frutdhënës. SHBSH organizon seminare e takime me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive ku këmbehen përvojat e bëhen sugjerime e jepen mendime për përmirësimin e punës në qeverisjen vendore. Veçanërisht të dobishme konsiderohen takimet e organizuara në zbërthim të ligjeve apo akteve të tjera nënligjore që ndihmojnë në zgjidhjen e shqetësimeve të hasura në punën e përditshme.

ii. Midis SHBSH dhe qeverisjes qendrore

Bashkëpunimi me qeverinë qendrore ka qenë mjaft i gjerë këtë vit. Gjatë vitit 2008 janë bërë tre takime me kryeministrin. Takimi i parë u realizua më 18 janar, me kërkesën e shoqatës në zbatim të programit të miratuar në mbledhjen e Komitetit Drejtues të shtatorit 2007. Në këtë

takim morën pjesë edhe dy ministra, Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit. Tematika kryesore e diskutimit u përqendrua tek projektligji për urbanistikën. Qëllimi ishte tërheqja e mendimit të grupeve të interesit siç janë edhe bashkitë për të vendosur rregull në planifikimin urban.

Anëtarët e komitetit drejtues, pjesëmarrës në takim, dhanë mendime dhe ngritën shqetësimet e pushtetit vendor para kryeministrit duke theksuar:

- Përcaktimin e saktë të penalteteve për kohëzgjatjen e afateve si në dhënien e lejes së ndërtimit dhe kolaudimin.
- Çështjen e ngritjes së nivelit të pagave në qeverinë vendore pasi në shumë bashki ekspertët e fushave të veçanta si urbanistë, juristë, financiarë nuk pranojnë të punësohen pranë administrates së bashkive.
- Gjetja e një forme më të përshtatshme për koordinimin vertikal dhe atë horizontal. Një problem që ka shqetësuar kryetarët e bashkive gjatë zbatimit të ligjit në fuqi është gjetja e formulës për të harmonizuar interesat publike me ato private, si dhe ato privat – privat në drejtim të pronave që preken nga instrumentet e zhvillimit apo planifikimit, çka është debatuar mjaft gjatë diskutimit të dokumentit të politikës së planifikimit hapësinor.

Takim tjetër i Komitetit Drejtues të SHBSH me kryeministrin dhe ministrat e TKRS dhe të PPTT u zhvillua në Sarandë, më 3 maj, në një konferencë që SHBSH organizoi për rolin e pushtetit vendor në zhvillimin e turizmit.

Në këtë takim Kryeministri e konsideroi shumë të rëndësishëm rolin e kryetarëve të bashkive për demokratizimin e qeverisjes vendore dhe bashkëpunimin e mirë të deritanishëm midis dy niveleve të pushteteve. Duke folur për këtë bashkëpunim theksoi se:

- Reforma e decentralizimit është në rrugë të mbarë dhe qeveria gjithnjë e më tepër do ta ndihmojë këtë duke *dy e trefishuar grantin për qeverisjen vendore.*
- Një *riorganizim i ndarjes administrative* bazuar në lëvizjen e popullsisë dhe ndryshimet demografike që kanë ndodhur në këto 17 vite shtrohet si kërkesë e ditës.
- Bashkitë të rishikojnë menaxhimin e burimeve njerëzore dhe efikasitetin e punës së tyre me qëllim që *të rrisin pagat sipas produktit të realizuar nga specialistët e kualifikuar për vendin përkatës të punës.*
- *Prokurimi elektronik* ishte një drejtim tjetër i domosdoshëm i punës së bashkive që kryeministri e nënvizoi në mënyrë të veçantë për tu zgjidhur nga kryetarët, pasi me mënyrën e vjetër të prokurimit nuk mund të vazhdohet më tej nivel vendor.

Problemet e rregullimit të territorit dhe pojektligji i hartuar për të mbledhën sërish sëbashku përfaqësues të Shoqatës së Bashkive dhe kryeministrin e stafin e tij për të diskutuar për këtë projektligj. Takimi i zhvillua në Pallatin e Kongreseve në tetor 2008 për të diskutuar rreth draftligjit për Planifikimin Hapësinor.

iii. Midis SHBSH dhe organizatave të tjera që punojnë me pushtetin vendor

SHBSH ka marrëdhënie të vlerësuara me shoqatat e tjera që veprojnë në fushën e qeverisjes vendore, si SHKSH, SHQSH, CO-Plan, ISB, SNV, IDRA, IDN, URI, etj.

Marrëdhëniet e vlerësuara konsistojnë jo vetëm në pjesëmarrje në veprimtaritë recproke, por edhe në zhvillimin e projekteve të përbashkëta. Mund të përmendnim projektin e EPTISA-s “One stop shop” mes SHBSH, SHKSH e SHQSH. Një projekt i dobishëm është ai LOGIN në fushën e informacionit për pushtetin vendor ku SHBSH e COPLAN janë partnerë.

Përvec kësaj Ekspertë të OJF-ve të ndryshme, URI, ISB, COPLAN, SHKSH ftohen për të mbajtur leksione në seminarët e trajnimet e SHBSH-së, duke këmbyer kështu përvojën e vlefshme midis shoqatave e qeverisjes vendore.

III. Bashkëpunimi rajonal

Ngjarja më e spikatur e këtij viti ishte realizimi për herë të parë në Shqipëri i Asamblesë së Përgjithëshme të NALAS. Ishte një ndër marrje e madhe e kryer me sukses nga SHBSH.

Aktiviteti u zhvillua në dy ditë. Ditën e parë më 23 nëntor u organizuan dy tryeza të rrumbullakëta, e para për “Decentralizimin Fiskal në Evropën Juglindore në kontekstin e Krizës Fiskale Globale”. Prezantimet e përfaqësuesve të shteteve të ndryshme dhe ekspertëve trajtuan probleme të tilla si:

1. *Si të sigurojmë mbështetje për zhvillimin institucional për Autoritetet e Qeverisjes Vendore në Evropën Juglindore*
2. *Mbështetje buxheti kundrejt projektit të financuar*
3. *Harmonizimi i mbështetjes si kontribute për qëndrueshmërinë financiare të Autoriteteve të Qeverisjes Vendore.*

Në tryezën e dytë të zhvilluar me donatorët me temë: “Të vëmë në jetë Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës”, pas prezantimeve të drejtuesve të NALAS-it për parimet dhe instrumentet për zbatimin e

Deklaratës së Parisit për efektivitetin e Ndihmës në vendet e Evropës Juglindore, donatorët mbështetës (SDC, GTZ, etj.) shprehën opinionet dhe vlerësimet e tyre për mbështetjen e dhënë në shtete të ndryshme të rajonit.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Autoriteteve Vendore të Evropës Juglindore theksoi që bashkitë dhe komunat të jenë të përgatitura për rreziqet që vijnë nga kriza ekonomike ndërkombëtare. Mesazhi i këtij takimi qe i qartë: Ballkani të jetë i përgatitur për krizën ekonomike.

IV. Trajnimet

Një ndër synimet e planifikuara të SHBSH-së ka qenë trajnimi i stafëve të bashkive për probleme thelbësore të ecurisë së tyre ***si legjislacioni i ri në shërbim të qeverisjes vendore, financat vendore, taksat vendore, policia bashkiake, problemet e buxhetit, të burimeve njerëzore, të strehimit, etj.***

Në zbatim të këtij synimi janë kryer një sërë seminaresh rajonale në Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Lushnjë, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Elbasan, Fier, Pukë, Patos, Përmet, Pogradec, Tepelenë, Ura-Vajgurore Laç. Duhet theksuar se për realizimin e tyre ka mbështetur financiarisht Fondacioni "Hanns Seidel", të cilin e falënderojmë për mbështetjen e dhene sidomos në drejtim të trajnimeve.

Në seminarët e zhvilluara me tematikën e mësipërme kanë dalë një sërë problemesh e janë ngritur shqetësimet e pjesëmarrësve në lidhje me përvojën e përditshme në sektorët përkatës. Do të rendisim sipas tematikës disa prej shqetësimeve kryesore të ngritura prej pjesëmarrësve në këto seminare:

Një seminar për **"Planifikimin territorial" dhe "Huamarrjen"** u zhvillua më 24-25 janar 2008 me specialistët e bashkive për ligjet e projektligjet e reja në shërbim të qeverisjes vendore ku u diskutua gjerësisht për:

planifikimin territorial dhe u sugjeruan që:

- Projektligji duhet të parashikojë zgjidhjen e duhur për konfliktet e mundshme në planifikim si në nivelin horizontal ashtu edhe atë vertikal,
- Projektligji duhet të jetë në harmoni me legjislacionin në këtë fushë dhe akoma më mirë do të jetë kalimi i tij si një paketë ligjore,
- Projektligji duhet të parashikojë në detaje ndarjen/qartësimin e kompetencave në planifikim midis këshillit të bashkisë dhe Kryetarit të bashkisë si dhe momentet kur nuk arrihet kompromisi midis tyre,

- Nevoja për një ndarje të re administrative të vendit duhet të gjejë mbështetjen edhe nga ky projektligj në drejtim të planifikimit territorial,
- Vendimmarrja në planifikim të ruajë skemën e decentralizuar sipas ligjit organik të pushtetit vendor Nr. 8652 dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese,
- Projektligji të parashikojë momentin “0” kur do të hyjnë në fuqi efektet e tij si në kohë ashtu dhe në hapësirë,
- Hyrja në fuqi e projektligjit të pasohet me një seri seminaresh trajnimi për njohjen e ligjit nga zyrat e urbanistikës në bashki,
- Të përgatiten formularë të standardizuar tip për lejet e ndërtimit sipas ligjit të ri.

Ndërsa Ligji **“Për huamarrjen vendore”** u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë si ligj nr. 9869, datë 4.02.2008. Kjo është një arritje për pushtetin vendor në zbatim të reformës së decentralizimit dhe fuqizimit të mëtejshëm të kësaj qeverisjeje. Ishte i rëndësishëm, njohja dhe diskutimi nga pjesëmarrësit i koncepteve dhe parimeve kryesore të parashikuara në këtë ligj, siç u theksua në seminar. Shembujt praktikë të zbatimit të ligjit e bënë më interesant aktivitetin dhe u sugjerua:

- Skema e miratimit të huamarrjes vendore nga Ministri i Financave të jetë në përputhje me parimet e autonomisë vendore,
- Të asistohen bashkitë në procesin e përgatitjes së kërkesave për hua,
- Të zhvillohet një tryezë e rrumbullakët me sektorin bankar për çështjen e huamarrjes vendore,
- Të nxiten skemat e institucioneve financiare të specializuara në kreditë për sektorin publik.
- Të trajnohen bashkitë për mënyrën e marrjes së kredive.

Në këtë seminar, gjithashtu u prezantua nga eksperti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit skema e kriterëve për ndarjen e fondeve në kuadrin e **granteve konkurrues**. Pjesëmarrësit propozuan që:

- Skema e grantit të ndahet më vete për kategori të ndryshme të bashkive dhe komunave (të mëdha; të mesme dhe të vogla)
- Të mos aplikohet parimi, që bashkitë e mëdha paraqesin 3 projekte, të voglat 2 projekte dhe komunat 1 projekt, pasi është një parim diskriminues dhe cënon thelbin e konkurrencës,
- Koha për paraqitjen e aplikimeve është e shkurtër dhe si e tillë duhet të zgjatet,
- Financimi i projekteve duhet të jetë mundësisht sipas kuotës së plotë të projektit ose në 2 faza por jo më shumë, sepse kjo ndikon në uljen e efikasitetit të investimit.

Fuqizimin e Rolit të Këshillave Bashkiakë në Qeverisjen Vendore ishte tema e seminarit të zhvilluar në datat 28-29 shkurt me pjesëmarrjen e kryetarëve të këshillave dhe këshilltarëve bashkiakë.

Synimi i tij ishte njohja e pjesëmarrësve me rolin dhe veprimtarinë e shoqatës, legjislacionin për qeverisjen vendore dhe për të vjelur mendime për përmirësimin e bashkëpunimit këshill dhe staf bashkiak.

E veçantë e këtij seminari ishte diskutimi i rolit udhëheqës që anëtari i këshillit bashkiak duhet të zotërojë. Pasi u përcoll ecuria e projektit për lidhshimin të zbatuar në disa bashki, pjesëmarrësit këmbëzën eksperiencat personale. U dhanë disa opinione dhe sugjerime të dobishme si:

- Të kërkohet që mbledhja e Këshillit Bashkiak të jepet nga televizioni lokal që të ndiqet nga komuniteti që e ka zgjedhur.
- Të mos miratohet buxheti pa u analizuar zbatimi i atij paraardhës.
- Të nxitet procesi i transferimit të pronave dhe regjistrimi në hipotekë.
- Të këmbëngulet nga SHBSH rritja e pagave të punonjësve të bashkive.
- Të përmirësohet Kodi Zgjedhor për zgjedhjen e këshilltarëve jo sipas listës por sipas zonave elektorale.
- Të miratohet "standardi minimal" në dhënien e informacionit prej këshillave bashkiake.
- Të informohen dhe trajnohen këshilltarët në mënyrë të përhershme.

Një tjetër lloj seminari tematik i kërkuar nga bashkitë ishte ai për "**Taksat vendore**". 5 seminare u zhvilluan gjatë muajit mars në Tiranë, Sarandë, Vlorë, Lezhë dhe Elbasan, ku morën pjesë kryetarë të bashkive (ose zëvendëskryetarë), përgjegjës të zyrave të taksave të bashkive dhe juristi që mbulon problemet fiskale të bashkisë. Në to u trajtuan:

- **Ndryshimet e fundit ligjore në sistemin fiskal në Shqipëri** duke u ndalur në mënyrë të veçantë në ligjin nr. 9844. "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe u prezantuan disa ndryshime që parashikohen në projektligjin "Për procedurat tatimore".
- "**Për ecurinë e punës me taksat vendore**" referuan përfaqësues të bashkive pritëse.
- "**Përmirësimet e nevojshme në veprimtarinë e organeve vendim marrëse dhe atyre ekzekutive të bashkive në punën me taksat vendore**" ishte një tjetër fushë për të cilën u diskutua.

Pjesëmarrësit morën pjesë gjallërisht me diskutimet e tyre dhe në lidhje me momentin kur u zhvilluan seminare, në fund u arritën disa konkluzione që po i përmendim në vijim si:

- *Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve, pa mohuar avantazhet ka sjellë disa vështirësi në punën e administratës tatimore të bashkive që lidhet me:*
 - Mosngritja ende e zyrave të QKR në ca rrethe ka vështirësuar punën për regjistrimin e bizneseve dhe në komunikimin e bashkive me to.

- Në rastet e mosregjistrimit të biznesit nuk është parashikuar ndonjë variant i angazhimit të administratës tatimore të bashkisë për regjistrim. Nga ana e bashkive propozohet deri edhe në hapësirat që mund t'i jepen kësaj administrate për të paraqitur në QKR kërkesen për regjistrim të subjekteve të veçanta.
- Në NIPT-in që i jepet një subjekti pas regjistrimit në QKR, informacioni është shumë i kufizuar dhe bashkitë nuk marrin informacionin e nevojshëm për llojin e aktivitetit, vendndodhjen, të domosdoshme këto për përcaktimin e detyrimeve tatimore ndaj bashkisë, etj.
- *Në lidhje me miratimin së fundi të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” nga ana e bashkive shtrohen disa probleme:*
 - Biznesi i vogël nuk ka marrë mjaftueshëm dijeni për problemet që u dalin dhe detyrimet e tyre proceduriale si dhe tatimore në zbatim të tij.
 - Biznesi i vogël e ka mjaft të vështirë të mbajë dokumentacionin e parashikuar nga aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Kjo sidomos për biznese në zonat periferike ku ka vështirësi në kapacitetet njerëzore në fushën financiare.
- *Nga ana e bashkive ngrihet problemi i metodikave në përcaktimin e nivelit të qarkullimit kryesisht për të shmangur vlerësimin subjektiv. Me hyrjen në fuqi të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” bashkitë ndeshin vështirësi për shkak të kontradiktës që krijohet nga përcaktimi i qarkullimit në marrëdhëniet e biznesit të vogël me pushtetin vendor për efekt të taksës për biznesin e vogël dhe deklarimit apo vlerësimin të këtij qarkullimi në fund të vitit në bilancin vjetor përkatës sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili ndërkohë shërben edhe si bazë për përcaktimin e detyrimeve për vitin pasardhës.*

*

Gjatë muajit prill 2008 u organizuan **5 takime pune** zonale në Elbasan, Gjirokastër, Lushnjë, Shkodër dhe Tiranë, **me punonjës të policisë së bashkisë** për të këmbyer përvojën gjatë ushtrimit të këtij profesioni dhe për të sugjeruar përmirësimet që mund të bëhen në këtë fushë. Në këto takime morën pjesë rreth 90 persona të mbi 40 policive bashkiake. Përmbledhtazi mund të themi që:

- Në të gjitha bashkitë funksionon policia bashkiake,
- Këshillat e bashkive kanë miratuar aktet e nevojshme për funksionimin e policive bashkiake.

Në këto takime u shtrua nevoja e miratimit të statusit të punonjësve të policisë bashkiake dhe mundësi e vendosjes së gradave që siguron pranimin dhe mbrojtjen në punë të tyre.

*

Në **2 Maj 2008**, në Sarandë, u zhvillua një konferencë **mbi veprimtarinë e pushtetit vendor në lidhje me zhvillimin kombëtar, rajonal dhe lokal të turizmit.**

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga bashkia e Sarandës, Kucovës, Përmetit, Gramshit, Kavajës, Burrelit, Patosit, Beratit, Memaliaj , Bilishtit, Peqinit, Kamëz, Lezhës, Rrëshenit, Rubikut, Kukësit, Hasit, Bajram Currit, etj. Në këtë takim morën pjesë edhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Brendshme si dhe punonjës të administratës që mbulojnë sektorin e turizmit në bashkinë Sarandë.

Ndër temat e referuara në konferencës ishin “Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit dhe Planifikimit të Qëndrueshëm të tij” mbajtur nga znj. Franka Paloka si dhe “Aplikimi i ligjit të turizmit në pushtetin vendor “ mbajtur nga z. Kadri Gega.

Diskutimet e pjesëmarrësve prekën çështje të cilat ndihmojnë në planifikimin e saktë të zhvillimit të turizmit në nivel kombëtar rajonal dhe lokal. Si problem i veçantë u diskutua evidentimi i burimeve turistike nga ana e njësive vendore, evidentimi i bizneseve turistike si dhe grumbullimi i të dhënave për fluksin turistik në çdo njësi vendore.

*

Në gjashtëmuorin e parë 2008, **për problemet e strehimit** janë zhvilluar takime të veçanta në Bashkinë e Tiranës dhe të Durrësit si dhe 5 takime zonale në Shkodër, Kavajë, Ura –Vajgurore, Burrel dhe Pogradec ku morrën pjesë përfaqësues (drejtues dhe specialistë) nga 16 bashki. Takimet shërbyen për të diskutuar për hartimin e programeve 10 vjeçare të strehimit nga bashkitë.

Nga bashkitë pjesëmarrëse në takime u konstatua se janë të pakta bashkitë si **Korça, Berati, Lezha** e më pak ndonjë bashki tjetër që po punojnë për hartimin e programeve 10 vjeçare të strehimit. Në pjesën më të madhe të bashkive puna është përqendruar deri në informacionin për gjendjen dhe aplikimin e kërkesave për strehim dhe ka raste ku ende trajtimi i kërkesave për zgjidhjen e tyre bëhet në frymën e legjislacionit të mëparshëm (para daljes së ligjit 9232).

Gjatë muajit nëntor 2008, u zhvilluan tre takime zonale, në Shkodër, për zonën e veriut, në Berat, për zonen jugore e bregdetare dhe në Tiranë për zonën e Shqipërisë së mesme dhe atë juglindore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte që, nepërmjet prezantimit të draft-manualit për strehimin, të bëhet edhe një hap i dytë për sensibilizimin e bashkive në angazhimin që duhet të kenë në fushën e strehimit, të qartësohen veprimet dhe procedurat për hartimin e programit 10 vjeçar të strehimit, si dhe të

nxiten bashkitë që, në buxhetin e vitit 2009 të planifikojnë fonde për fushën e strehimit.

Një **Takim Kombëtar për Strehimin u organizua më 4 dhjetor** ku morën pjesë drejtues të bashkive dhe përfaqësues të ministrive të ndryshme, të cilët dhanë opinionet e tyre për zgjidhjen e problemeve të strehimit. Me këtë rast u shpërnda edhe manuali “Për programin 10 vjeçar të bashkive për strehimin”.

*

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, me mbështetjen e Fondacionit Hanns Seidel, në periudhën 26 deri me 30 qershor 2008, organizoi tre takime zonale **“Për ujësjellsat”** në Korçë, Fier dhe Lezhë.

Qëllimi i takimit ishte që të asistohen bashkitë për një ecuri sa më të suksesshme në fushën e menaxhimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, në kushtet menjëherë pas transferimit tek ata të këtij funksioni. Drejtues të bashkive (kryetari ose zëvendëskryetari i bashkisë), shefi i zyrës përkatëse në administratën e bashkisë si dhe drejtori i Ndërmarrjes së Ujësjellës – Kanalizimeve që mbulon bashkinë morën pjesë në këto mbledhje.

Në to u trajtuan problemet që dalin në kushtet aktuale ligjore lidhur me “Transferimin institucional në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet” ku, krahas decentralizimit të përgjegjësive është bërë e mundur ndër vite edhe transformimi i mënyrës së menaxhimit të ndërmarrjeve, proces që po shoqërohet me transformimin në kuadrin sektorial të ujësjellës – kanalizimeve, i akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

E reja në këto takime ishte prezantimi i situatës në shkallë vendi për gjendjen e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, me shumë shembuj konkretë për zonat përkatëse. Dhënia e mendimeve të pjesëmarrësve për të zgjidhur shqetësimet që hasin ishte efektive për këtë seminar.

*

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me mbështetjen e Fondacionit Hanns Seidel, në periudhën 17 deri më 28 tetor 2008, organizoi gjashtë seminare zonale me temë **“Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit”**. Qëllimi i këtyre takimeve ishte trajtimi i problemeve që dalin në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të qeverisjes vendore, sipas ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Zhvillimi i seminareve në 6 zona të ndryshme të vendit, Pukë, Laç, Tiranë, Tepelenë, Pogradec dhe Patos mundësoi një pjesëmarrje të gjerë (mbi 100 persona) dhe mjaft aktive në diskutimin e problemeve. Temat kryesore rreth të cilave u diskutua ishin “Buxheti si rregullator i financave publike në njësitë e qeverisjes vendore”, “Roli i organeve të qeverisjes vendore në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit”, “Buxheti në njësitë e qeverisjes vendore dhe ligjet përkatëse”.

*

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, e mbështetur financiarisht nga Fondacioni Hanns Seidel, organizoi në muajin nëntor një seminar për **problemet e burimeve njerëzore** ku u prezantuan e trajtuan çështjet e ligjshmërisë për nëpunësin civil, u këmbyen përvojat e bashkive të ndryshme në zbatimin e kësaj ligjshmërie, si dhe trajnimi e kualifikimi i nëpunësve civilë të qeverisjes vendore si një element i rëndësishëm për një një qeverisje të mirë.

Përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike dhe Institutit të Trajnimit pranë saj dhanë opinionet dhe sugjerimet e tyre nisur nga përvoja e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil dhe problemet që hasen në pushtetin vendor.

Një problem tepër i rrahur nga bashkitë ishte **çështja e pagave të qeverive vendore** që janë mjaft të ulëta krahasuar me punën e programuar për tu kryer. Ky nivel pagash nuk nxit për rendiment më të lartë dhe çon në largimin e specialistëve të aftë nga bashkitë. Kryetarë bashkish dhe drejtorë të drejtorive të burimeve njerëzve u fokusuan shumë në këtë problem pavarësisht se nuk gjetën mbështetjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme.

Shpërndarje gjeografike e trajnimeve

Duhet të nënvizojmë se seminarët e trajnimit janë zhvilluar në qytete të ndryshme, nga veriu në jug të vendit në bashkëpunim me bashkitë pritëse që i përmendëm në krye të raportit.

Mbështetje nga donatorë të ndryshëm

Përsa i takon donatorëve mbështetës të trajnimeve tona do të falënderojmë Fondacionin Hanns Seidel për financimin e shumicës së trajnimeve të kryera.

Donatorë të tjerë janë GTZ për projektin Integrimin Urban të Zonave Informale, LGI dhe OSI për Informacionin në bashkëpunim me Co-PLAN, Keshilli i Evropës për Liderhipin, etj.

V. Shërbimet ndaj anëtarëve

i. Veprimtaritë brenda vendit

Duke folur për shërbimin ndaj anëtarëve të shoqatës do të theksojmë se të gjitha trajnimet janë kryer në përputhje me nevojat dhe kërkesat e bëra nga bashkitë.

Po kështu pjesëmarrja në diskutim ligjesh për qeverisjen vendore është bërë në shërbim të bashkive dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre..

ii. Pritje miqsh e kolegësh

Në datat 20-23 korrik 2008, një delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës zhvilloi një takim pune e shkëmbim përvoja me shoqatën e Bashkive të Shqipërisë. Delegacioni kosovar drejtohej nga kryetari i AKK, z. Bajram Rexhepi.

Në këto takime u fol rreth problemeve të ecurisë së reformës së decentralizimit të qeverisjes vendore, të kontributit të ngjajshëm të dy shoqatëve homologe në zbatimin e kësaj reforme. Në takimet e zhvilluara u trajtuan edhe roli i stafit dhe të zgjedhurve në arritjet e dy shoqatave homologe. Mjaft të dobishme ishin vizitat e delegacionit në bashkitë e Durrësit dhe Kavajës.

iii. Veprimtari jashtë vendit

Një sërë veprimtarish janë zhvilluar edhe jashtë vendit për të mësuar e këmbyer përvoja në fushën e qeverisjes vendore të vendeve evropiane të zhvilluara.

Do të nënvizonim vizitat studimore në Poloni, në Spanjë, Bullgari ku kanë qenë pjesëmarrës mjaft kryetarë bashkie.

Një delegacion i SHBSH-së i kryesuar nga kryetari i saj bënë një vizitë nga 18-21 prill në Republikën e Maqedonisë me ftesën e homologes BNJVL. Në të gjitha takimet, Kryetarët e Komunave pritëse prezantuan strukturën e Komunave, veprimtarinë e tyre për të realizuar funksionet që kryenin sipas legjislacionit si dhe problemet që hasnin për t'i shërbyer më mirë komunitetit. Kudo Kryetarët si dhe stafet e tyre shprehën dëshirën e madhe për të rritur bashkëpunimin midis vetë njësisve të qeverisjes vendore, për të shkëmbyer përvojat, informacione botime si dhe çdo gjë tjetër që fuqizon e zhvillon njësitë vendore. Në memorandum, të dy shoqatat ranë dakord që:

1. Të dy palët të japin mbështetje në përforcimin institucional dhe zhvillimin e dy organizatave,

2. Të nxitin bashkëpunimin direkt ndërmjet pushteteve vendore të Shqipërisë dhe Maqedonisë nëpërmjet vendosjes së kontakteve të ndërsjella,
3. Të përgatisin dhe të konkurrojnë bashkërisht (përfshirë konkurse para donatorëve ndërkombëtarë) si dhe të bashkëpunojnë në implementimin e programeve të shumta me rëndësi për komunat & bashkitë.

Për realizimin e kësaj marrëveshjeje, të dy organizatat do të miratojnë plane veprimtarie të përbashkëta që zbatimi i saj të jetë konkret dhe efikas.

Në kuadër të Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal, Intercooperation Shqipëri dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë organizuan **një vizitë studimore në Poloni, nga data 19-22 Maj**. Në përbërje të delegacionit ishin kryetarët e 8 bashkive/komunave të Qarkut Shkodër.

Objektivi kryesor ishte informimi i partnerëve kryesorë të Programit të Zhvillimit Lokal dhe Decentralizimit (PZHDL), për praktikat e mira të qeverisjes vendore, decentralizimit dhe zhvillimit rajonal në rajon. Polonia është një vend i mirë referimi me një skemë të ngjashme decentralizimi si Shqipëria dhe është anëtare e BE-së, që është qëllimi dhe vizioni afatmesëm i shtetit shqiptar.

Axhenda e vizitës prekte disa prej çështjeve problematike me të cilat përballen edhe njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri si:

1. Informimi dhe komunikimi me qytetarët (veçanërisht shembuj të one-stop shops, qendrat e informimit të qytetarëve)
2. Bashkëpunim ndër-bashkiak/komunal në disa shërbime (veçanërisht menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë si një temë kyç për NjQV-të shqiptare)
3. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes nivelit vendor dhe rajonal të qeverisjes
4. Akses në fondet e BE-së, si mund të aplikojnë NjQV-të tona, të krijojnë partneritete, etj.
5. Planifikimi dhe menaxhimi i bashkisë.

Aktivitet mbresëlënës ishte edhe ai në Austri, ku krahas veprimtarisë sportive u vendosën lidhje me bashkitë e shteteve pjesëmarrëse.

Në datat 28-30 Maj, SHBSH e ftuar nga Shoqata e Njesive të Qeverisjes vendore të Austrisë mori pjesë në kampionatin e futbollit të bashkive evropiane në Salzburg.

VI. Projektet

i. Projekti i Lidërshiptit

Ky projekt është zhvilluar me efikasitet në bashkitë e Laçit, Përmetit, Beratit, Shijakut dhe Kamzës dhe përfundoi me konferencën përmbyllëse në tetor 2008.

ii. Projekti për Integrimin Urban të Zonave Informale

Në datën 9 shtator 2008 në sallën e mbledhjeve të hotel “Adriatik” u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Bashkive të Vendeve të Europës Juglindore) dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, për projektin pilot “Integrimi urban i ndërtimeve pa leje në bashkinë Sukth”. Ky projekt do të vazhdojë dhe gjatë vitit 2009 dhe ka si objektiv kryesor mbështetjen për hartimin përfundimtar të planit urban të Bashkisë Sukth. Qëllimi i projektit **Franka**

iii. Projekti LOGIN www.logincee.org

LOGIN është rrjeti informativ i qeverisjes vendore i krijuar për të nxitur dhe promovuar zhvillimin profesional të zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe stafit të tyre. LOGIN lehtëson shkëmbimin e informacionit nëpërmjet internetit dhe metodave tradicionale si: seminare, botime, konferenca, trajnime, etj. Shoqata e Bashkive në bashkëpunim me Co-Plan, kanë filluar zbatimin e këtij projekti duke vendosur materiale në faqen e internetit të LOGIN-it mjaft të domosdoshme në fushën e pushtetit vendor. Gjithashtu në faqen e shoqatës www.aam-al.com është vendosur një link me emrin login ku të gjithë aktoret e interesuar mund të klikojnë dhe të shohin direkt faqen e LOGIN-it.

iv. Projekt për mbledhjen e të dhënave për pikat e nxehta në mjedis.

Ky ishte një projekt i shkurtër i PNUD –it, gjatë muajit qershor –korrik 2008, ku SHBSH si partner u ngarkua të grumbullonte të dhëna nga bashkitë për pikat e nxehta mjedisore. Të dhënat e grumbulluara iu dërguan PNUD-it për të përgatitur hartën e pikave të nxehta mjedisore e cila do të bëhet burim për zhvillimin e projekteve të tjera për mbrojtjen e mjedisit bazuar në të dhënat statistikore të prezantuara.

v. Projekti për Strehimin

“Programi për ngritjen e kapaciteteve të bashkive për administrimin e problemeve të strehimit” i iniciuar dhe i kërkuar nga ana e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), u zbatua nga ana e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (SHBSH). Ai pati për qëllim të nxisë bashkitë për t’u angazhuar me problemet e strehimit si dhe për

rritjen e nivelit të menaxhimit nga ana e tyre, në kuptimin dhe zbatimin e skemave ligjore të strehimit.

Programi pati si **objektiv përgatitjen e një manuali për hartimin e një programi 10 vjeçar strehimi të bashkisë**. Në manual përfshihen drejtimet e punës dhe masat që duhen marrë nga bashkitë, plani i zbatimit dhe ai financiar, që do të shërbejnë si bazë për programimin e veprimeve që duhet të ndërmerret bashkia, përcaktimi i procedurës së planifikimit të fondeve për strehimin në nivel qendror, si dhe të lehtësohet bashkëpunimi midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

vi. Projekti për Konfliktin e interesit

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen e USAID do të hartojë një manual mbi parandalimin e konfliktit të interesit në nivel vendor. Qëllimi i hartimit të këtij manuali është trajtimi i *Konfliktit të Interesit* në nivel vendor, trajnimi i nëpunësve vendorë në lidhje me konfliktin e interesit në mënyrë që të shmangen dhe parandalohen pasojat që derivojnë nga ky konflikt. Rezultati i këtij punimi do të jetë një manual në duart e publikut ku do të trajtohen problematikat e ligjit të parandalimit të konfliktit të interesit nëpërmjet kuptimit të funksioneve dhe kompetencave të pushtetit vendor dhe organeve të tij qeverisëse.

vii. Projekt me Intercooperation Shqipëri

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka një bashkëpunim të mirë me IC Intercooperation. Jemi financuar për organizimin e një seminari për prokurimet publike, vazhdon financimi i Gazetës së Bashkive për një vit sipas projektit, dhe është financuar udhëtimi studimor në Poloni për disa kryetarë bashkie të qarkut Shkodër. Përfaqësuesi i SHBSH merr pjesë në mbledhjen tremujore të IC Intercooperation me prezantime sipas tematikës së miratuar.

VII. Botimet

i. Gazeta e Bashkive

Botohet çdo muaj sipas një tematike të miratuar më parë me donatorin. Duhet punuar për gjetjen e fondeve për vazhdimësinë e botimit të saj. Konsiderohet e dobishme nga bashkitë bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të mbledhur.

ii. Manuali për strehimin

Është produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve të bashkive për administrimin e problemeve të strehimit. Do të shpërndalet në tërë bashkitë si një manual i dobishëm për to.

iii. Fletëpalosje për SHBSH

Është botuar një fletëpalosje e shoqatës për të prezantuar veprimtarinë e saj gjatë kohëve të funksit e dobishme për tu paraqitur para bashkëpunëtorëve, kolegëve, donatorëve.

iv. Faqja në Internet e SHBSH-së

Prej disa vjetësh, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë i vjen akoma dhe më afër Bashkive, Donatorëve, OJF-ve, Institucioneve Qëndrore si dhe të gjithë aktorëve të interesuar nëpërmjet faqes së saj të internetit: www.aam-al.com. Në këtë adresë ju mund të gjeni informacione mjaft të dobishme në fushën e qeverisjes vendore si: legjislacionin bazë dhe ndryshimet e fundit të akteve ligjore; projekte dhe raporte; seminare të organizuara në bashkitë e Shqipërisë dhe problematikat dhe shqetësimet që hasin në fusha të ndryshme të pushtetit vendor.

Gjithashtu mund të gjeni në këtë faqe në formë elektronike të gjitha botimet e Shoqatës së Bashkive, link-et e bashkive të cilat disponojnë faqe interneti si dhe informacion dhe mundësi kontakti me Bashkitë e Shqipërisë.

Mirëpresim nga ana Juaj çdo sugjerim dhe mendim për të ndryshuar ose shtuar informacione në faqen tonë të internetit.

Aktiviteti i datës 22 – 23 dhjetor??